



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**

**Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor**

Mbledhja nr. 37

Prishtinë, më 24.2.2009, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

**PROCESVERBAL**  
**nga mbledhja e Komisionit**

Në mbledhje **morën pjesë**: Lulzim Zeneli, Zulfi Merxha, Naim Maloku, Myrvete Pantina, Heset Cakolli, Elhëme Hetemi, Ali Lajçi, Zef Morina.

Munguan : Dragisha Miriç, Selvie Halimi (pushim lindjes) dhe Berat Luzha (udhëtim zyrtar).

**Të ftuarit** dhe pjesëmarrësit tjerë : zyrtarët nga MBPZHR: Fadil Musa dhe Isah Rudaku, nga OSCE Blerim Vela dhe Maria Berishaj.

**Nga stafi mbështetës** i komisionit : Bajram Badivuku

Mbledhjen e kryesoi : **Lulzim Zeneli**, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**
- 2. Shqyrtimi i projektligjit për bujqësinë dhe zhvillimin rural,**
- 3. Të ndryshme.**

**Kryesuesi Lulzim Zeneli** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, hapi mbledhjen për pikat e rendit të ditës.

**1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar**

**Kryesuesi** konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**2. Shqyrtimi i projektligjit për bujqësinë dhe zhvillimin rural**

**Lulzim Zeneli** ftoi anëtarët e komisionit dhe zyrtarët e MBPZHR për rishqyrtim dhe miratim të vërejtjeve nga mbledhja e kaluar për këtë projektligj, ndaj u miratuan amendamentet si vijon:

**Amendamenti 1**

Në tërë tekstin e projektligjit:

-“Monitorimi” zëvendësohet me “Mbikëqyrja”,

- “Implementimi” zëvendësohet me “Zbatimi”,
- “Agjension” të shkruhet “Agjencion”,
- të përmirësohen disa gabime drejtshkrimore, p.sh. “trainimin” të shkruhet “trajnimin” etj,
- dy versionet tjera të ligjit duhet të përkthehen dhe të përshtaten versionit shqip, për shkak të numrit sa më të vogël të amendamenteve që do të hartohen.

## **Amendamenti 2**

Neni 2, në paragrafin 1, fjala “rregullon” zëvendësohet me “përcakton”.

## **Amendamenti 3**

Neni 3, në fillim fjalia riformulohet:

**Shprehjet apo termat e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:**

Tek përkufizimi “Masë e politikës bujqësore dhe zhvillimit rural”, në fund shprehja “me këtë ligj” do të zëvendësoi shprehjen “me nenin 16 të këtij ligji”.

Përkufizimi “Shërbim publik” riformulohet : “Shërbimi publik në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural” nënkupton politikat qeveritare në ofrimin e shërbimit nëpërmjet programeve të saja, me qëllim të avancimit të mëtejshëm të sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural.”

## **Amendamenti 4**

Neni 4, paragrafi 4, pika 1.4 riformulohet :

“Cilësia e prodhimeve të ushqimit duke garantuar që zinxhiri ushqimor është i një cilësie të qëndrueshme dhe i plotëson standardet e përcaktuara.”

## **Amendamenti 5**

Neni 5 paragrafi 2, riformulohet : “Plani kombëtar i Bujqësisë dhe zhvillimit rural hartohet nga Ministria e Bujqësisë në bashkëpunim me institucionet e tjera përkatëse, dhe me propozim të Qeverisë miratohet në Kuvendin e Kosovës”.

## **Amendamenti 6**

Paragrafi 2 dhe 3 i nenit 6 bashkohen duke fshirë tekstin “3. Plani i veprimit përfshinë:”.

## **Amendamenti 7**

Neni 7, titulli riformulohet :”Parimet mbi të cilat bazohen masat e politikës bujqësore”.

## **Amendamenti 8**

Neni 15, titulli riformulohet :”Shfrytëzimi i informatave nga bazat tjera të të dhënave”.

## **Amendamenti 9**

Neni 18, paragrafi 2, riformulohet :”Ministria përcakton tregun përfaqësuese të produkteve bujqësore dhe ushqimore, personave fizik apo juridik që do të japin të dhëna, duke përcaktuar tipin, vëllimin dhe kohën e grumbullimit të të dhënave”.

## **Amendamenti 10**

Neni 19, paragrafi 1, riformulohet:

“Për përfituesit nga masat e politikës së bujqësisë dhe të zhvillimit rural, është i detyrueshëm mbajtja e kontabilitetit. Fermat jo përfituese mund të mbajnë kontabilitet në baza vullnetare”.

## **Amendamenti 11**

Neni 29,

Komisioni sugjeroi që : Naim Maloku, Blerim Vela dhe dy zyrtar të MBPZHR, të premtën në orën 13,00 të sqarojnë se a duhet para kapitullit X të shtohet ndonjë nen sqarues lidhur me procedurën para ankesës, sepse neni 29 është pa objekt.

## **Amendamenti 12**

Neni 30 të shikohet mundësia e ndërrimit të afateve, 18 të bëhet 12, ndërsa në paragrafin 2 , numri dy (2) të bëhet 12.

## **Të ndryshme**

**Zylfi Merxha** tha se në cilësinë e nënkryetarit e mbështet kërkesën e koordinatorit të komisionit **Bajram Badivukut** për kualifikim të mëtejshëm në punën profesionale për **jurist mjedisor** dhe kërkon nga OSCE ta mbështet në këtë drejtim. Anëtarët tjerë të komisionit nuk kundërshtuan kërkesën e tillë.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 14,10, mbledhja e radhës do të mbahet më 3.3.2009 në orën 13,00 kur do të shqyrtohet komisioni përfundimisht vërejtjet nga dita e premtë më 27.3.2009, dhe do të vazhdoi me shqyrtimin e projektligjit të radhës.

Mbledhja përfundoi në orën 14,20.

Kryetari i Komisionit,  
**Lulzim Zeneli**